



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 105 paragrafi (1) alinea (1) nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 41 dhe neni 47 të Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr.58/2006, 35/2008, 150/2010, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.96/19) dhe neni 50 dhe neni 51 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.102/2019), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 06.11.2024 miratoi:

VENDIM

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT NË GJYKATËN THEMELORE STRUGË

Për kryetar i Gjykatës Themelore Strugë është zgjedhur:

1.Vullnet Vinca- gjyqtar në Gjykatën Themelore Ohër;

Ky vendim do të hynë në fuqi pas mbarimit të potëfuqishëm të procedurës dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi shpallje për zgjedhjen e kryetarit në Gjykatën Themelore Strugë ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.241/23 nga 15.11.2023).

Në shpalljen e publikur për në Gjykatën Themelore Strugë është paraqitur 1 (një) kandidatë.

Procedurën për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Themelore Strugë, Këshilli e zbatoi në pajtim me Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të Republika e Maqedonisë së Veriut. Në përputhje me Rregulloren e mënyrës së formimit të Komisionit për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, si dhe mënyrën e punës së Komisionit, Këshilli formoi Komision të cilën e verifikoi dorëzimin në afatin e fletëparaqitjeve dhe kompletimin e dokumenteve të kandidatëve të paraqitur në publikimin e shpalljes për kryetar të gjykatës dhe e shqyrtoi plan programin dhe planit veprimit të kandidatit, të kandidatit për kryetar të Gjykatës Themelore Strugë. Është bërë testimi psikologjik dhe testi i integritetit, është bërë interiviju ne kandidatin, në përputhje me Ligjin për ndryshim dhe plotësimpët Ligjin për gjykata (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.150/10) për kandidatët të cilët janë të zgjedhur si gjyqtarvpara 26.11.2010 nuk mbahet punë praktike e njohurive me kompjuter, prandaj nuk është kryer një kontroll i tillë për kandidatin.

Komisioni i formuar nga ana e Këshillit Gjyqësor i RMV-së e pas realizimit të procedurës, Regullores për mënyrën e formimit të Komisioni për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, si dhe mënyra e punës së Komisionit, përgaditi raport me propozimin e listës së kandidatëve:

PROPOZIM I KANDIDATËVE PËR KRYETAR TË GJYKATËS THEMELORE STRUGË

Nr.	Emri dhe Mbiemri kandidatit	Gjykat në të cilën ka punuar	Stazh në Gjyqësi	Nota për punën në vitin 2019-2022
1.	Vullnet Vinca	-Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ohër -I deliguar në Gjykatën Themelore Strugë nga 12.02.2024 -UD kryetar në Gjykatën Themelore Strugë nga 13.02.2023	Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ohër 07.02.2006 (gjithësej 17vjet e 8 muaj)	pozitive

Në përputhje të nenit 51 paragrafi (1) nga Ligji i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është paraparë se këshilli zgjedhë kryetar të gjykatës nga radhët e kandidatëve ve të paraqitur në shpallje, dhe për kryetar gjykate zgjedhët më së paku me tetë vota të anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Në nenin 50 paragrafi (1) nga Ligji i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është paraparë se këshilli zgjedh gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës themelore dhe të apelit që gjendet në zonën e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin një gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, vendos në pajtim me nenin 49 të këtij ligji, duhet të ketë shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm të cilët u takojnë komuniteteve në të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në seancën e mbajtur më 06.11.2024, Këshilli Gjyqësor diskutoi në lidhje me kandidaturën për kryetar të gjykatës dhe anëtarët e Këshillit u deklaruan për arsyet për të cilën e japin votën e tyre, dhe të cilat janë shënuar në procesverbal të seancës së lartpërmendur, pas së cilës Këshilli ka votuar sipas renditjes të rangë listës.

Kandidati në rangë listën Vullnet Vinca me 13 vota "Për" mori votat e duhur nga numri i përgjithëshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në përputhje me nenin 51 paragrafin (1) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Me 5 vota "Për" kandidati mori shumën e votave të anëtarëve të pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas neni 50 paragrafi (1) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RMV-së.

Çdo anëtar i këshillit me të drejtë vote ka dhënë arsyetim për vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit, i cili parashikohet në nenin 5 paragrafi (3) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Vullnet Vinca ka stazh të përgjithëshëm 17 vjet e 8 muaj nga dita e paraqitjes së shpallje. Si gjyqtar ka punuar me materje civile. Si gjyqtar ka punuar në

sferën civile. Nga arsyetimi i anëtarëve të Këshillit, rezulton se bëhet fjalë për një gjyqtar me përvojë shumëvjeçare dhe me rezultate të vërtetuara në punën e tij, gjatë periudhës për të cilën është vlerësuar dhe konfirmuar rezultate në punën e tij, jatë periudhës për të cilën është vlerësuar gjatë vlerësimit të fundit, ka fituar numrin maksimal të pikëve të përcaktuara me ligj - 200 pikë me cilësi profesionale dhe kualitet profesional, me reputacion dhe integritet të mirë, me qëllime dhe aktivitete të përcaktuara qartë në Programin e Punës me një Plan veprimi, me afatë të përcaktuara saktësisht për përmbushjen e të njëjtit, me rezultate të mira të demonstruara në funksionim dhe menaxhim të mirë dhe ballafaqim me mungesën e gjyqtarëve si UD kryetar i Gjykatës Themelore Strugë, me përvojë shumëvjeçare dhe si një gjyqtar por edhe si kryetar UD kryetar do të kontribuonte në funksionimin dhe menaxhimin suksesshëm të punës në Gjykatën Themelore Strugë.

Duke pasur parasysh të gjitha si më sipër, Këshilli Gjyqësor për kryetar të Gjykatës Themelore Strugë zgjodhi Vullnet Vincën, gjyqtar në Gjykatën Themelore Ohër.

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT**
Kryetar,
Vesna Dameva



**Nr.09-2139/1
07.11.2024
Shkup**